

Ph.D. Alket Jaupi.

Propozuar nga Avokati i Popullit.

Aktualisht është ndihmëskomisioner, në seksionin e administratës, në institucionin e Avokatit të Popullit. Z. Jaupi është pedagog i jashtëm, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Shtetëror, Tiranë, si dhe në disa universitete private në vend, prej vitit 2004 e në vijim. Aktualisht është pedagog i jashtëm pranë Departamentit të së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Kolegji Universitar i Biznesit. Ka përfunduar studimet e larta në Drejtësi (1991-1995), si dhe Master (SHPU) – (2006-2008), në të Drejtë Publike pranë Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit Shtetëror Tiranë. Z Jaupi, ka mbrojtur gradën “Doktor” (viti 2018), pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, me fokus tek siguria dhe kombëtare dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri.

Ka kryer trajnime kërkimore të ndryshme sidomos në fushën e të drejtave të njeriut; për kuptimin dhe funksionimin e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, organizuar nga Akademia e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe ENNHRI; për të drejtën e informimit, organizuar nga USAID, United States Agency - International Development, Washington; masat efektive ndaj moszbatimit të vendimeve gjyqësore të gjykatave të vendit, organizuar nga Këshilli i Evropës në Strasburg; liria e tubimit dhe e krijimit të shoqatave, organizuar nga Komisioni i Venecias, Këshilli i Evropës, Trieste; për të drejtat e minoriteteve, organizuar nga Komisioni i Venecias, Këshilli i Evropës, Trieste, si dhe një trajnim i dytë i së njëjtës fushë i organizuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, USA, etj.

Z. Jaupi është autor i një sërë artikujsh shkencorë dhe ka referuar në disa konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Eksperienca e tij profesionale përfshin edhe angazhimin si, anëtar i Komitetit Teknik, për Institucionet e Sektorit të Drejtësisë në vend, ngritur nga bashkëpunimi i Shqipërisë me Programin Danez të Ndihmës në Tranzicion (Danida); anëtar i grupit të punës, në projektin e përbashkët “Për Shtetin Ligjor në Shqipëri”, të USAID me Avokatin e Popullit, “Për Rregulloren tip për të Drejtën e Informimit”; anëtar i Grupit të Punës për implementimin e Rekomandimeve të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës, ngritur dhe koordinuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme, të Republikës së Shqipërisë; anëtar i grupit të punës, në projektin e përbashkët “Për Shtetin Ligjor në Shqipëri”, të USAID me Avokatin e Popullit, për përgatitjen e një rekomandimi “Për çështjet e ankimit administrativ dhe praktikën e organeve të administratës publike në këtë fushë”; ekspert i projektit të përbashkët të Zyrës së Fondacionit “Soros” në Shqipëri, me Open Society Justice Initiative (SHBA), “ dhe Qendrën për Zhvillimin Demokratik të Institucioneve (QZHDI): Reforma ligjore për ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Alket Jaupi Ph.D**Proposed by the Ombudsman.**

He is currently an assistant commissioner in the administration section of the Ombudsman institution. Mr. Jaupi is also an adjunct lecturer at the Faculty of Law, State University of Tirana, as well as at several private universities in the country, since 2004 onward. Currently, he serves as an adjunct lecturer in the Department of Public Law, Faculty of Law, at the University College of Business. He completed his higher education in Law (1991-1995) and a Master's degree (SHPU) in Public Law (2006-2008) at the Faculty of Law, State University of Tirana. Mr. Jaupi earned his "Doctor" degree in 2018 at the Armed Forces Academy, focusing on national security and human rights in Albania.

He has undertaken various research training, particularly in the field of human rights, including understanding and functioning of National Human Rights Institutions organized by the Academy of National Human Rights Institutions and ENNHRI; on the right to information organized by USAID, United States Agency for International Development, Washington; on effective measures against non-implementation of court decisions by national courts organized by the Council of Europe in Strasbourg; on freedom of assembly and association organized by the Venice Commission, Council of Europe, Trieste; on minority rights organized by the Venice Commission, Council of Europe, Trieste, as well as a second training on the same field organized by the U.S. Department of State, etc.

Mr. Jaupi is the author of a series of scientific articles and has presented at several national and international scientific conferences. His professional experience also includes serving as a member of the Technical Committee for Justice Sector Institutions in the country, established through Albania's collaboration with the Danish Assistance Program in Transition (Danida); a member of the working group in the joint project "For the Rule of Law in Albania," by USAID and the Ombudsman, developing the model regulation for the Right to Information; a member of the Working Group for implementing the European Committee for the Prevention of Torture Recommendations, coordinated by the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Albania; a member of the working group in the joint project "For the Rule of Law in Albania," by USAID and the Ombudsman, preparing recommendations for "administrative appeal issues and the practice of public administration bodies in this field"; and as an expert for the joint project by the Soros Foundation Office in Albania, with Open Society Justice Initiative (USA) and the Center for Democratic Development of Institutions (CDDI): Legal Reform for Law no. 8503, dated 30.06.1999 "On the Right to Information on Official Documents."